

Studentë të Universitetit të Elbasanit pjesë e Digi Camp & Digital Skills Festival 2026 në Prizren

Gjashtë studentë të programit të studimit Informatikë-Ekonomike të Fakultetit të Biznesit dhe i Drejtësisë në Universitetin e Elbasanit, të shoqëruar nga pedagogu Dr. Erind Bedalli, morën pjesë në aktivitetin ndërkombëtar Digi Camp & Digital Skills Festival 2026, i zhvilluar në Innovation and Training Park (ITP) Prizren. Gjatë tri ditëve të festivalit, studentët u përfshinë në një sërë aktivitete inovative, duke përfshirë JunctionX Regional Hackathon, Next Quest Game Jam, punëtori interaktive, sesione trajnimi, aktivitete rrjetëzimi dhe prezantime projektesh.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e teknologjisë, inovacionit, sipërmarrjes dhe transformimit dixhital, si dhe të bashkëpunojnë me studentë, mentorë, ekspertë dhe përfaqësues institucionesh nga Kosova dhe rajoni. Nën moton “Learn. Build. Grow.”, festivali krijoi një mjedis frymëzues për shkëmbimin e ideve, zhvillimin e projekteve inovative dhe krijimin e lidhjeve të reja profesionale, duke kontribuar në përgatitjen e të rinjve për sfidat e ekonomisë dhe shoqërisë dixhitale.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” mbështet dhe inkurajon vazhdimisht pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare që promovojnë inovacionin, teknologjinë dhe zhvillimin profesional.



